

**VENDIM**  
**Nr.168, datë 17.3.2021**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE VORË DHE SHIJAK TË  
OBJEKTEVE ARSIMORE, KOPSHTI “MUÇAJ”, BASHKIA VORË, KOPSHTI NR.1  
DHE SHKOLLA E MESME “16 SHTATORI”, BASHKIA SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në pronësi të bashkive Vorë dhe Shijak, përkatësisht, të objekteve arsimore kopshti “Muçaj”, Bashkia Vorë, kopshti nr.1 dhe shkolla e mesme “16 Shtatori”, Bashkia Shijak, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Vorë e Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

Nr.	Bashkia	Njesia Administrative	Niveli	Emertimi	Tipologjia e Nderhyrjes	Financimi i Ndertimit	Siperfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e Projekt Idese	Vle e projektit te zbatimit dhe ndertimit	Vlera e Mbiqerresit	Vlera e koaludimit	Vlera totale e objektit
19	Shijak	Shijak	e mesme	Gjmnazi 16 Shatori	Ndertim	Buxhet GoA	2,400.0	838,420.45	80,880,000.00	848,302.26	98,146.50	82,664,869.21
20	Shijak	Shijak	kopesht	Nr. 1	Ndertim	Buxhet GoA	1,160.0	405,236.55	39,092,000.00	410,012.76	47,437.48	39,954,686.78
36	Vore	Mucaj	kopesht	Mucaj	Ndertim	Buxhet GoA	516.0	75,726.67	17,389,200.00	182,384.99	21,101.50	17,668,413.15
<b>TOTAL</b>							<b>4,076.0</b>	<b>1,319,383.7</b>	<b>137,361,200.0</b>	<b>1,440,700.0</b>	<b>166,685.5</b>	<b>140,287,969.1</b>